



VENDIM NR. 5 Date 2006/2005
I asamblese se ortakeve te shoqerise

Ne Tirane , sot me date 20/06/2005, asambleja e ortakeve te shoqerise
"Qeramika e Jugut" sh.p.k.

KONSTATOI SE

Shoqeria tregtare " QERAMIKA E JUGUT " sh.p.k. eshte regjistruar ne
Gjykatën e Shkalles se pare Tirane me vendimin nr. 6825 date 24/10/ 2004 me
ortaket Perparim Skenderi, Shpetim Bega dhe Asllan Baraj.

Gjate periudhes se veprimtarise se kesaj shoqerise jane bere ndryshime ne
aktet e shoqerise te cilat jane te depozituara ne zyren e regjistrimit tregetar te Gjykates
se Shkalles se Pare Tirane.

Aktualisht kjo shoqeri rezulton e perbere nga ortaket : Perparim Skenderi me
34 % te pjeseve te kapitalit dhe ortaket Shpetim Bega dhe Asllan Baraj me nga
33% te pjeseve te kapitalit te kesaj shoqerise. Gjithashtu kapitali i shoqerise rezulton te
jete ne masen 22 300 000 (njezete e dy milione e treqind mije) leke.

Asambleja e ortakeve te shoqerise duke vendosur te rrise kapitalin e shoqerise,
me vendimin nr. 04 te dates 14. 06.2005 ka vendosur te shtoje kapitalin e shoqerise
ne vlerë nga fitimi i trashëguar dhe ka caktuar eksperte kontabel te autorizuar znj.
Stoli Laze per te paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit te shoqerise,
raport i cili eshte paraqitur prej saj.

Ne keto kushte, e mbledhur sot me date 20 qershor 2005, asambleja e ortakeve te
kesaj shoqerise me unanimitet votash qe perbejne 100% te pjeseve te kapitalit te
shoqerise :

VENDOSI

1. Miratimin e aktit te ekspertimit te paraqitur nga eksperti kontabel i
autorizuar znj. Stoli Laze.
2. Te shtohet kapitali themeltar i shoqerise "Qeramika e Jugut" nga vlera
aktuale 22 300 000 (njezete e dy milione e treqind mije) leke, ne vleren 25
000 000 (njezetete pese milione) leke .
3. Te paraqiten ndryshimet ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.
4. Te behet depozitimi i ketij vendimi ne zyren e regjistrimit tregetar te Gjykates se
Shkalles se Pare Tirane.

Per sa me siper ortaket rane dakort dhe nenshkruan.

Perparim Skenderi

Shpetim Bega

Asllan Baraj